REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2018:060287
Datë: 03.09.2019
Numri i dokumentit: 00489471

**P. nr. 46/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Gjakovë/ Dega Malishevë- Departamenti i Përgjithshëm- gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit R. (Sh.) G. nga K. Rr. "M. H.", për shkak të veprës penale kanosje nga neni185 par. 3/1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP. nr. 460/17, të datës 01.02.2018, në shqyrtimi fillestar të mbajtur më datën 08.04.2019, në prezencën e prokurorit te shtetit Nazmi Krasniqi, të dëmtuarit Y. K., të akuzuarit R. G.,më datën **11.04.2019** mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **R. G.,** nga i ati Sh., e ëma H., e gjinisë H., i lindur më datën ... në K. ku dhe jeton, i martuar, atë i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknik-ndërtimtari, me profesion ndërtimtarë, i pa dënuar më parë, me numër personal ....

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

Me dt. 25.01.2017 rreth orës 14:35 min në Malishevë, përmbaruesit privat të dëmtuarit Y. (M.) K. nga fsh. M. K. Malishevë, i shkakton ankth dhe frikë, në atë mënyrë që, për shkak të bllokimit të xhirollogarisë së tij për borxhin prej ... Euro, e thirr të dëmtuarin me telefonin e tij ... e fillimisht e ofendon me fjalë "ku je o laper" e më pas e shan me fjalë se nëse nuk ma hekë bllokadën unë ta q...nëne, gruan dhe kënd ke" e më pas e kanos seriozisht me fjalët "se ka me të vra" me çka tek i dëmtuari ka shkaktuar ankth e frik.

-me çka ka kryer vepër penale kanosje nga neni 185 par. 3/1 të KPRK-së.

2018:060288

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4,41,42,43,49,50,51,52,73,74, 185 par. 3/1 të KPRK-së dhe neneve 248 dhe 365 të KPPRK-ës, të pandehurit i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që i pandehuri **R. G.**dënohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej dy (2) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohen i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,oo €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,oo €,në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari Y. K. nga fshati M., Komuna e Malishevës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PP. nr. 460/17, të datës 01.02.2018, kundër të akuzuarit R. G.nga K. Rr. “M. H.”, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par. 3/1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt. 08.04.2019, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendim se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, pasi që janë plotësuar kushtet e para me nenin 248 par 1 të KPRK-së, dhe pranimi i fajësisë mbështeten në faktet e çështjes që përmban aktakuza, i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bahet vullnetarisht nga i pandehuri andaj i propozoj gjykatës që këtë shprehje të lirë të vullnetit ta aprovoj dhe të njëjtit ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

I dëmtuari Y. K., deklaroj e nuk e kërkoj që të dënohet dhe nuk kërkoj kompensim demi, dhe kërkoj që të njëjtit të ja fali kompensimin e dëmit jo material, dhe nuk kam asgjë të keqe nga ajo ditë.

I pandehuri R. G., deklarohet i fajshëm për akuzën, i kërkoj falje të dëmtuarit, me vjen keq, që e kamë kryer e kamë kryer për herë të parë, nuk kam pasur ndonjë qellim të keq.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se aj me datë, kohë dhe vend si në diapozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti Fillestar i Incidentit nr. ... i dt. 26.01.2017; Raporti policor mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit- dëmtuarit Y. K. dhënë ne Stacionin Policor M. nr. ... i dt. 26.01.2017; Raporti policor mbi marrjen në pyetje e të dyshuarit/ pandehurit R. G. dhënë ne Stacionin Policor M. nr. ... i dt. 26.01.2017; parashtresa e Përmbaruesit Privat Y. K. lëshuar sipas lendes P. nr. 32/2016, dt. 10.01.2017, ne emër te debitorit R. G.; raporti i oficerit A. K. nr..., dt. 26.01.2017, si dhe shkresat tjera ne lende.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është hera e pare qe e ka kryer një vepër penale, është mbajtës i familjes prej 5 anëtar, i ka kërkuar falje te dëmtuarit, nuk ka pasur ndonjë qellim te keq, i dëmtuari nuk ka kërkuar nga i pandehuri kompensim demi material, jo material, e as me u dënuar, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se me këtë lloj të veprës penale është bere kanosje ndaje personit zyrtare ne kryerjen e detyrës zyrtare me qellim frikësimi dhe ankthi per mos bllokimin e xhirollogarisë ne sistemin bankare te Kosovës, po ashtu edhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale si dhe motivin e kryerjes së kësaj vepre penale e cila në këtë rast ishte frikësimi dhe ankthi ndaj personit zyrtare gjate kryerjes se pozitës zyrtare per qellim mos pagimi te borxhit personit të tjetër e nëpërmes Përmbaruesit Privat, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej dy (2) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me ketë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË**
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**
**P. nr. 46/18, Datë: 11.04.2019**

**Zyrtarja ligjore** **Gjyqtari**
Albane Morina Njazi MORINA

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.